



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2019:245763

Datë: 10.06.2024

Numri i dokumentit: 05802673

**C.nr.354/19**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË SKENDERAJ**, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Nderim Musa, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.A. (KEDS), me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit V.L., jurist pranë paditëses, kundër të paditurit F.A., nga fshati..., Komuna e Skenderajt, me objekt kontesti, kompensim dëmi, vlera e kontestit 226.24 Euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me datë **03.06.2024**, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**APROVOHET** në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.A. (KEDS), me seli në Prishtinë, **DETYROHET** i padituri F.A., nga fshati..., Komuna e Skenderajt, që t'ia paguajë paditëses në emër të dëmit material shumën prej 216.24 Euro, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e parashtrimit të padisë të datës 30.07.2019, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 20.00 Euro, në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit.

**A r s y e t i m**

Paditësja, me padi, në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka kërkuar që kërkesëpadia të aprohet në tërësi si e bazuar, dhe të detyrohet i padituri që t'ia paguajë paditëses në emër të dëmit material shumën prej 216.24 Euro, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e parashtrimit të padisë të datës 30.07.2019, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 20.00 Euro.

Ka shtuar se i padituri prej datës së pavërtetuar e deri me datë 01.07.2017, dhe 29.11.2017, ka shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë të paautorizuar, me ç'rast është shpallur fajtor sipas aktgjykimit penal P.nr.54/18, të datës 20.04.2018, dhe P.nr.164/18, të datës 27.06.2018.

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje kontestimore, është mbyllur në mungesë të të paditurit i cili është ftuar në mënyrë të rregullt ndërsa mungesën nuk e kishte arsyetuar.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike sipas propozimit të palëve ka zhvilluar procedurën dhe ka administruar provat: Procesverbalin nr.2464039, i datës 01.07.2017; Raportin nr.0609074, i datës 20.07.2017; Procesin për pranim të instalimit elektrik, nr.065687, i datës 15.06.2016; faturën e kalkulimit nr.138999, të datës 20.09.2017; faturën e rikthimit të humbjeve, të datës 21.09.2018; kallëzimin penal, të datës 30.03.2018; Aktgjykimin P.nr.237/18, i datës 19.09.2018; Procesverbalin nr.2088837, i datës 29.11.2017; Faturën e kalkulimit nr.155182, të datës 06.12.2017; Faturën e rikthimit të humbjeve të datës 06.12.2017, dhe Aktgjykimin P.nr.338/18, të datës 21.12.2018.

Gjykata pasi bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, arriti në përfundimin se në këtë çështje juridike kontestimore duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi:

Nga procesverbali nr.2464039, i datës 01.07.2017, dhe nr.2088837, i datës 29.11.2017, vërtetohet fakti, se paditësja pas kontrollës në shtëpinë e të paditurit ka hasur në shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike nga i padituri.

Nga Raporti nr.0609074, i datës 20.07.2017, vërtetohet fakti, se paditësja ka bërë ndërrimin e njëhësorit për verifikim.

Nga procesi për pranim të instalimit elektrik, nr.065687, i datës 15.06.2016, vërtetohet fakti, se paditësja pasi ka bërë ndërrimin e njëhësorit, ka bërë instalimin e ri të njëhësorit të shtëpia e të paditurit.

Se i padituri ka shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë të kundërligjshme në lartësinë e aprovuar, vërtetohet nga faturat e rikthimit të humbjeve, dhe faturat e kalkulimit të administruara si prova.

Se i padituri është shpallur fajtor për veprën penale Vjedhje e Shërbimeve Komunale, nga neni 320 të KPK-së, vërtetohet nga aktgjykimi P.nr.237/18, i datës 19.09.2018, dhe P.nr.338/18, i datës 21.12.2018, sipas kallëzimit penal të bërë nga paditësja.

Me dispozitat e nenit 136 par. 1 të LMD-së, përcaktohet se: *“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*, me nenin 140 të LMD-së, përcaktohet se: *“Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia”*.

Me dispozitat e nenit 169 par. 1 të LMD-së, përcaktohet se: *“Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi”*, me par. 2 përcaktohet se: *“Në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin, personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të japë shpërblimin në të holla”*, me par. 3 përcaktohet se: *“Kur rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk është e mundur, apo kur gjykata konsideron se nuk është e domosdoshme që këtë ta bëjë personi përgjegjës, gjykata do të caktojë që ai t`ia paguajë të dëmtuarit shumën përkatëse në të holla në emër të shpërblimit të dëmit”*, ndërsa me par. 4 përcaktohet se: *“Gjykata do t`i gjykojë të dëmtuarit shpërblimin në të holla kur ai këtë e kërkon, me përjashtim kur rrethanat e rastit konkret e arsyetojnë rivendosjen e gjendjes së mëparshme”*.

Nga gjendja faktike e konstatuar e në lidhshmëri me të drejtën materiale të sipërcituar, gjykata ka vërtetuar se i padituri është përgjegjës për kompensimin e dëmit, konform përgjegjësisë në bazë të fajsisë, të paraparë me dispozitat e lartëcituar, e lidhur me nenin 14 LPK-së, ku përcaktohet se: *“Në procedurën kontestimore gjykata, në pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryerësit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor”*. Po ashtu paditësja si provë gjykatës i`a ka parashtruar edhe faturën mbi shpenzimin e paautorizuar të energjisë elektrike me nr. DMIHP1712247, të datës 26.04.2010, dhe nr.DMIHP1711896, të datës 21.09.2017, e të cilat janë hartuar konform rregullave dhe procedurave të aprovuara nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë Elektrike (ZRREE), të cilës gjykata i`a fali besimin e plotë, e përmes të të cilave prova është vërtetuar lartësia e shumës së shpenzuar të energjisë elektrike në mënyrë të kundërligjshme nga ana e të paditurit, respektivisht lartësia e dëmit që i është shkaktuar këtu paditëses nga ana e të paditurit.

Me nenin 35 par. 1 të Rregullores për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji (RR.nr.12/2017) përcaktohet se: *“Nëse fillimi i shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë nuk mund të përcaktohet, atëherë për konsumatorët familjarë do të merret që shfrytëzimi i paautorizuar i energjisë ka filluar gjashtë (6) muaj para datës kur Konsumatori është gjetur*

*duke bërë shfrytëzim të paautorizuar të energjisë, ndërkaq për konsumatorët tjerë dymbëdhjetë (12) muaj para datës kur Konsumatori është gjetur duke bërë shfrytëzim të paautorizuar të energjisë, ose nga dita e inspektimit të fundit kur instalimi ka qenë në rregull”, ndërsa me par. 2 përcakohet se: “Për llogaritjen e faturave për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë do të zbatohen tarifat e aplikueshme në datën kur është identifikuar shfrytëzimi i paautorizuar i energjisë, gjegjësisht në datën e përpilimit të procesit nga ekipi i kontrollës, dhe për konsumatorët shtëpiak do të zbatohen tarifat e grupit një-tarifor të ndara sipas sezoneve (verë, dimër), kurse për konsumatorët tjerë do të zbatohet tarifa e lartë e grupit që i përket, gjithashtu të ndarë sipas sezoneve”.*

Nga dispozitat e rregullores së sipërcituar, përcaktohet procedura, se si bëhet llogaritja e lartësisë së shpenzuar e energjisë elektrike për rastet kur fillimi i shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë nuk mund të përcaktohet.

Nga aktgjykimet penale me të cilat është shpallur fajtor i padituri, është vërtetuar, se i padituri në periudha të papërcaktuara e deri me datë 01.07.2017, dhe 29.11.2017, ka shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë të kundërligjshme, prandaj, duke u nisur nga fakti që ka qenë e pamundur që të vërtetohet fillimi i shfrytëzimit të pa autorizuar, rezulton se paditësja mbi bazën ligjore të përcaktuar me rregulloren e sipërtheksuar me të drejtë ka llogaritur dhe ka faturuar humbjen e cila në këtë rast është vlerësuar në shumën prej 216.24 Euro, dhe atë për katër muaj (*sipas kalkulimit nr.138999, të datës 20.09.2017*), dhe për pesë muaj (*sipas kalkulimit nr.155182, të datës 06.12.2017*).

Gjykata ka vendosur që konform nenit 420 paragrafi 3 të LPK-së, shqyrtimin kryesor t’ a mbajë menjëherë pas seancës përgatitore, sepse nga paditësja në seancën përgatitore nuk janë paraqitur pretendime të reja faktike apo argumente juridike, nga ato të paraqitura në padi, dhe duke mos pasur nevojë për marrjen e provave, gjykata vendosi që shqyrtimin kryesor ta mbyll në mungesë të të paditurit, të ftuar në mënyrë të rregullt.

Lidhur me lartësinë e kamatës gjykata vendosi konform nenit 382 të LMD-së.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata vendosi konform nenit 449 lidhur me nenin 452 paragrafi 1 të LPK-së. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara për të paditësen i referohen taksës për padi në shumë prej 20.00 Euro.

Nga të cekurat në kuptim të nenit 143 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË SKENDERAJ**

**Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil**

**C.nr.354/19, të datës 03.06.2024**

Gjyqtari  
Nderim Musa

---

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.